



FUQIZIMI I

ZËRAVE

LOKAL

PËR ZHVILLIM TË BARABARTË

DOBROTA SMILE PËRQAFIM

ARDHMËRIA LEPA REÇ

UPOZNAVANJE LOVELY EXPRESSION

TOGETHERNESS SARADNJA

EMPATI TOGETHER BUDUÇNOST

APPRECIATION LJUBAV

SË BASHKU PODELI KINDNESS

PREPOZNAVANJE FJALE E KËNDSHME

NJOHJE FAMILIARITY

BUZËQESHJE BLISKOST

OSMEH SHARE

DASHAMIRËSI EMBRACE

DUAJE ZAGRRI

ZAJEDNIŠTVO CLOSENESS

DASHURI EMPATIJA AFËRSI

LEPA REÇ FUTURE APPRECIATION

NDANI BASHKËPUNIM ZAVOLI

EMPATHY ZAJEDNO UNION

LOVE IT COOPERATION

LOVE





...Fuqizimi i Zërave Lokal për Zhvillim të Barabartë...
LJUBAVDASHURILOVE



DOBROTA SMILE PËRQAFIM
 ARDHMËRIA AFËRSI LEPA REÇ
 UPOZNAVANJE LOVELY EXPRESSION
 TOGETHERNESS SARADNJA
 EMPATI TOGETHER BUDUÇNOST
 APPRECIATION **LJUBAV**
 SË BASHKU PODELI KINDNESS
 PREPOZNAVANJE FJALË E KËNDSHME
 NJOHJE FAMILIARITY
 BUZËQESHJE BLISKOST
 OSMEH SHARE
 DASHAMIRËSI
 DUAJE EMBRACE
 ZAJEDNIŠTVO ZAGRLI
 DASHURI CLOSENESSE
 EMPATIJA AFËRSI
 LEPA REÇ FUTURE APPRECIATION
 NDANI BASHKËPUNIM ZAVOLI
 EMPATHY ZAJEDNO UNION
 LOVE IT COOPERATION
LOVE



Historia e projektit “Fuqizimi i Zërave Lokal për Zhvillim të Barabartë (ALVED) nuk është një histori e zakonshme e mbështetur në numra dhe të dhëna të tjera statistikore, por një histori, epilogu i së cilës do të thotë shumë miqësi të reja, bashkëpunime pune dhe përvoja me anë të së cilave secili pjesëmarrës ka avancuar vetën para se gjithash, e më pas dhe komunitetin në të cilin jeton. Për afro tre vite (nga shtatori 2020 deri në mars 2023), të gjitha gjeneratat e banorëve të Vranjës, Bujanocit dhe Lebanit kanë bashkëpunuar dhe implementuar **mbi 100 aktivitete të ndryshme**, shpeshherë të cilave iu bashkëngjiten edhe aktivistët nga Presheva, të cilët gjithashtu kanë dhënë një kontribut të madh në rezultatet e përgjithshme. Qëllimi kryesor i këtyre aktiviteteve ishte të nxitë ndjeshmëri midis qytetarëve në jug të Serbisë, të inkurajojë qytetarinë aktive dhe të festojë diversitetin .

Fokusi i projektit ALVED ishte në tre fusha të rëndësishme: planifikimi me pjesëmarrje i shërbimeve sociale, nevojat dhe shqetësimet e të rinjve, si dhe fuqizimi i organizatave lokale të shoqërisë civile. Numri i përgjithshëm i përfituesve të drejtpërdrejtë në të gjitha aspektet e projektit është rreth 6000, ndërsa numri i përfituesve indirekt është shumë më i lartë.

Projekti në Serbi u zbatua nga një konsorcium udhëhequr nga organizata Nisma për Ndryshim Paqësor (PCi), në bashkëpunim të ngushtë me Njerëzit në Nevojë (PIN) dhe në partneritet me Iniciativat Qytetare, me financim nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar.

Në faqet në vijim, do t’ju prezantojmë aktivitetet që janë më shumë se aktivitete të projektit, sepse për ekipin e ALVED, dhe shpresojmë që për të gjithë pjesëmarrësit gjithashtu, ato nënkuptojnë një shkollë të vogël të jetës që kemi kaluar së bashku. **LJUBAVDASHURILOVE**



KOMUNITETET ME MUNDËSI TË BARABARTA

Planifikimi me Pjesëmarrje i Shërbimeve Sociale (PSSP) është një qasje e përbashkët për planifikimin e shërbimeve sociale, e cila përfshin të gjitha palët e interesuara në komunitetin lokal: shfrytëzuesit e shërbimeve sociale, organizatat e shoqërisë civile, autoritetet lokale, agjencitë qeveritare dhe ofruesit e shërbimeve sociale. Qëllimi kryesor i PSSP është të sigurojë që nevojat dhe interesat e grupeve të marginalizuara të merren parasysh në mënyrë transparente,



sistematike dhe kooperative. PSSP synon zvogëlimin e varfërisë dhe parandalimin e përjashtimit social duke fuqizuar grupet më të pambrojtura për të marrë pjesë në dialogun politik mbi çështjet e mbrojtjes sociale dhe gjithëpërfshirjes.

Duke përfshirë të gjitha palët në procesin e planifikimit, PSSP promovon një qasje tërësore të mbrojtjes sociale, duke siguruar që askush të mos lihet anash në përpjekjet globale për të arritur qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Që nga viti 2016, Njerëzit në Nevojë kanë punuar në fqinjësi të BE-së, duke marrë përvojë nga Republika e Çekisë dhe duke e adaptuar atë në kontekstin lokal. Si rezultat, qasja e PSSP është zbatuar me sukses në jug të Serbisë, në komunat e Vranjës, Bujanocit dhe Lebanit, duke çuar në miratimin e tre planeve të veprimit për përmirësimin e shërbimeve sociale.

Disa organizata nga këto komuna kanë realizuar me sukses elementet e planeve të veprimit, duke ofruar shërbime sociale

me cilësi të lartë me mbështetje financiare, infrastrukturore dhe jo monetare nga vetëqeverisjet lokale të Vranjës, Bujanocit dhe Lebanit, si dhe nga grantet e ALVED. Ndikimi i PSSP mund të shihet në punën e organizatave si **Shoqata për Ndhimë Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale (MNRO)** në Vranjë, e cila ofron mbështetje thelbësore për personat me invaliditet si skleroza e shumëfishtë, duke përmirësuar cilësinë e jetesës dhe statusin social të tyre.

Në të njëjtën mënyrë, Shoqata **Fenniks** në Leban ofron shërbime të kujdesit ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara zhvillimore. Përmes bashkëpunimit me komunën, ka filluar rinovimi i plotë i ndërtesës së qendrës për kujdes ditor, me qëllim të përmirësimit maksimal të burimeve për fëmijët.

Forumi Rinor për Edukimin e Romëve në Bujanoc është i dedikuar të ofrojë mundësi të barabarta në arsim dhe përfshirje sociale të grupeve të rrezikuara,

siç janë familjet e varfra dhe komuniteti rom, duke mbështetur arsimimin e fëmijëve përmes ndihmave financiare, teksteve falas dhe stimujve për ndjekjen e rregullt të mësimin dhe performancës akademike.

Organizatat tjera, si **Qendra Kulturore Rome** në Vranjë, fokusohen në parandalimin e disfunkcionit social, ndërsa **Komiteti për të Drejtat e Njeriut Vranjë** ofron një linjë të besueshme dhe të qëndrueshme telefonike SOS për gratë që janë viktime të dhunës në familje. Ngjashëm, **Shoqata e Grave Rome** në Bujanoc ka ndërmarrë masa proaktive për të tejkaluar pengesat e komunikimit për viktimat e dhunës, duke angazhuar dhe trajnuar një staf që do të mund të ofrojë mbështetje në tri gjuhë: serbe, shqipe dhe rome.

Qasja e PSSP ka pasur një ndikim pozitiv në shërbimet e mbrojtjes sociale në Bujanoc, duke krijuar një faqe interneti për Qendrën për Punë Sociale, nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të **Shoqatës The Future**, Komunës së Bujanocit dhe Qendrës për Punë Sociale.

Planet Lokale të Veprimit për Vranjë, Bujanoc dhe Leban mund ti gjeni këtu:

www.gradjanske.org/akcioni-planovi-usvojeni-tokom-alved-projekta/

Video rreth shërbimeve të mbrojtjes sociale që janë ofruar në kuadër të planeve të veprimit:

<https://www.youtube.com/watch?v=a0Sz2w0fhMY>

Vizita studimore në Pragë

Për të avancuar më tej me përpjekjet e tyre, përfaqësuesit e tre komunave morën pjesë në vizitën studimore në Republikën Çeke. Përmes ndërveprimit me organizatat lokale, ndërmarrjet sociale dhe institucionet që punojnë për të ofruar shërbime sociale për grupet e rrezikuara,



Vizitë në ndërmarrjen sociale Tulipan në Liberec, Republika Çeke; foto: GI



Turë në kuzhinën e shkollës së Jedličkův ústav për trajnimin e nxënësve në punët e shtëpisë dhe jetën e pavarur; foto: GI



Vizitë në ambientet e Programit të Integritit Social të PIN; foto: GI

13 përfaqësues nga Vranja, Bujanoci dhe Leban morën një pasqyrë të qartë të qasjes inovative dhe efikase në ofrimin e shërbimeve sociale. Në thelb të misionit tonë është bindja se edukimi dhe përvoja praktike kanë aftësi të sjellin ndryshime pozitive në botë.



Vizitë në Jako Doma, një organizatë që ofron kujdes për gratë e pastreha; foto: Dragan Cvetković



Vizitë në ambientet e organizatës Njerëzit në Nevojë (PIN) në Pragë, Republika Çeke; foto: GI

Qasja e PSSP ka ndihmuar dukshëm në përmirësimin e shërbimeve sociale në këto komuna dhe ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe përfshirjes në krijimin e programeve të qëndrueshme dhe me ndikim.





PUNA MË TË RINJTË ËSHTË ZEMRA E PROJEKTIT ALVED

Një pjesë veçanërisht e rëndësishme dhe sfiduese e projektit ishte puna me të rinjtë, duke marrë parasysh se është përfshirë një numër i madh i të rinjve në të gjitha komunat, mbi **1300 prej tyre**. Kemi punuar në tema shumë të rëndësishme dhe kemi

përfshirë fusha që kanë një efekt afatgjatë tek të rinjtë si individë, por dhe si anëtarë të grupeve aktiviste të cilët do të vazhdojnë të ndikojnë që shoqërinë në të cilën jetojnë ta bëjnë një vend më të mirë për të jetuar. Të gjitha aktivitetet me të rinjtë janë organizuar në bazë të iniciativës së tyre dhe bazuar në dëshirat dhe nevojat e tyre.

● AKTIVITETET PËR RREGULLIMIN E HAPËSIRAVE TË JETESËS:

- ▶ Pastrimi i deponisë së egër në Bujanoc
- ▶ Krijimi i Muralit të Unitetit në Vranjë
- ▶ Pastrimi i zonës së piknikut në Liqenin Aleksandrovaçko pranë Vranjës
- ▶ Mbjellja e pemëve të gjeneratës në shkollat "Sveti Sava" dhe "Sezai Surroi"
- ▶ Rregullimi i oborrit në Shkollën Kimike Teknologjike në Vranjë
- ▶ Aksioni për rregullimin e terrenit sportiv në Komunën e Bujanocit
- ▶ Rregullimi i kalatës buzë lumit Shimanka në Leban
- ▶ Mbjellja e pemëve në oborrin e Gjimnazit në Leban
- ▶ Rregullimi i kantinës në shkollat "Sezai Surroi" dhe "Sveti Sava"



Rregullimi i kalatës buzë lumit Shimanka në Leban; foto: GI



Pastrimi i zonës së piknikut në Liqenin Aleksandrovaçko në Vranjë; foto: GI



Mbjellja e pemëve të gjeneratës në shkollat "Sveti Sava" dhe "Sezai Surroi"; foto: GI



Krijimi i Muralit të Unitetit në Vranjë; foto: Atelieja e Artit Vranjë



Rregullimi i oborrit të Shkollës Kimike Teknologjike në Vranjë; foto: GI



Një numër i madh i të rinjve morën pjesë në pastrimin e deponisë së egër në Bujanoc; foto: GI

● AKSIONET HUMANITARE:

- ▶ Hapja e shtëpizave të solidaritetit në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban
- ▶ Fotosesion humanitar për Vulkanin
- ▶ Shpërndarja e dhuratave të Vitit të Ri për fëmijët e privuar socialisht në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban
- ▶ Ditë pune humanitare nga të rinjtë në ndërmarrjen sociale “Radanska ruzha” në Leban



Shpërndarja e dhuratave të Vitit të Ri për fëmijët e privuar socialisht në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban; foto: GI



Shpërndarja e dhuratave të Vitit të Ri për fëmijët e privuar socialisht në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban; foto: GI



Hapja e shtëpizave të solidaritetit në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban; foto: GI



Hapja e shtëpizave të solidaritetit në Bujanoc, Vranjë, Preshevë dhe Leban; foto: GI



Ditë pune humanitare nga të rinjtë në ndërmarrjen sociale “Radanska ruzha” në Leban; foto: GI



● SHËNIMI I DATEVE DHE TEMAVE TË RËNDËSISHME:

- ▶ Shënimi i Ditës Botërore të Vajzave në Vranjë
- ▶ Panel diskutimi mbi pozitën e grave rome dhe performanca e grupit Pretty Loud në Vranjë
- ▶ Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Rinisë
- ▶ Konkurs letrar “Përshkruaj bukurinë e vendin tënd”
- ▶ Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas
- ▶ Tribuna “Pse është e rëndësishme të raportohet dhuna në çift?”
- ▶ Shënimi i Ditës së Tokës
- ▶ Mbështetja e fushatës botërore “One Billion Rising”
- ▶ Shënimi i Ditës Botërore të Shëndetësisë në Bujanoc
- ▶ Vizitë studimore ndërmarrjes sociale “Radanska ruzha” me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas



Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Gruas në Bujanoc;
foto: GI



Të rinjtë e Bujanocit në mbështetje të fushatës botërore “One Billion Rising” kundër dhunës ndaj grave; foto: GI



Shënimi i Ditës së Tokës - ngjitja në kodrën Shiljati Kamen pranë Vranjës; foto: GI



Panel diskutimi mbi pozitën e grave rome dhe performanca e grupit Pretty Loud në Vranjë; foto: GI

● TRAJNIMET NË TEMA TË NDRYSHME TË REALIZUARA NË GJUHËN SERBE, SHQIPE DHE ANGLEZE:

- ▶ Aktivizimi rinor
- ▶ Bazat e fotografisë
- ▶ Gazetaria celulare
- ▶ Redaktimi i videos
- ▶ Ndërmarrësi
- ▶ Të drejtat e njeriut
- ▶ Aftësi digjitale
- ▶ Interkulturalizmi
- ▶ Barazia gjinore
- ▶ Aftësi komunikimi
- ▶ Edukimi mediatik
- ▶ Kurs i gjuhës serbe në Bujanoc dhe Preshevë
- ▶ Kurs i gjuhës angleze në Vranjë dhe Leban



Orë të gjuhës serbe dhe angleze në natyrë, në Kopshtin zoologjik pranë Vranjës; foto: GI



Trajnimi mbi barazinë gjinore në Leskoc; foto: GI



Kursi i gjuhës serbe në Preshevë tërhoqi interes të madh të rinjtë; foto: GI



Trajnimi mbi fotografinë i organizuar në gjuhën shqipe dhe serbe; foto: GI




Trajnimi "Nga A në Barazi dhe Liri" në Vranjë; foto: GI



Kursi i gjuhës angleze në natyrë pranë vendit arkeologjik Justiniana Prima, Leban; foto: GI

Praktikat

Një pjesë e veçantë e punës me të rinjtë ishin praktikat në organizatat e shoqërisë civile dhe mediat, të organizuara për të rinjtë nga Bujanoci, Vranja, Lebani dhe Presheva. Praktikrat janë organizuar në dy cikle. Në total, 13 të rinj kanë mbaruar praktikën një mujore, respektivisht dy mujore, ku **pesë prej tyre kanë arritur të punësohen menjëherë pas mbarimit të programit**. Dëshirojmë të shprehim mirënjohjen tonë ndaj organizatave dhe mediave të mëposhtme për bashkëpunimin e tyre: Komiteti për të Drejtat e Njeriut Vranjë, CRTA, BOŠ, Proaktiv, Qendra për të Drejtat e Njeriut në Beograd, PreshevaPRESS, Bujanovačke, InfoVranjske dhe JUGpress.



Nënshkrimi i kontratës për praktikën vullnetare ndërmjet të rinjve nga Bujanoci dhe Komitetit për të Drejtat e Njeriut në Vranjë; foto: GI

Një praktikante ka mbaruar praktikën e saj në Iniciativat Qytetare dhe vazhdoi të punojë aty.





Tur në Asambleshë e Serbisë si pjesë e vizitës studimore në Beograd; foto: GI



Vizita studimore në Beograd u karakterizua me shoqëri të shkëlqyer dhe momente vërtet të paharrueshme; foto: GI



Iniciativat Qytetare si nikoqir të vizitës studimore në Beograd për të rinjtë nga Prishtina, duke përfshirë edhe shoqërimin me studentët e Katedrës së Albanologjisë në Beograd; foto: PEN



Një tur në nëntokën e Beogradit si një përvojë e veçantë për pjesëmarrësit e vizitës studimore; foto: PEN

Vizitat studimore: Beograd dhe Prishtinë

ALVED theksoi dukshëm rëndësinë e shkëmbimit të përvojave dhe ideve midis të rinjve nga komunat e ndryshme. Ky theks u nxit nga të kuptuarit se përmes mësimit të ndërsjellët, të rinjtë mund të zhvillojnë përshtatshmëri dhe gatishmëri më të madhe për jetën, si dhe për t'u angazhuar në aktivizëm. Vizitat studimore në **Beograd në vitin 2021** dhe **Prishtinë në vitin 2022** ishin



Turë në qytetin e Prishtinës gjatë vizitës studimore; foto: GI

ngjarje të rëndësishme për projektin ALVED. Rinia nga Presheva, Bujanoci, Lebani dhe Vranja kaluan 5 ditë në Beograd dhe 4 ditë në Prishtinë, duke eksploruar atraksionet e qyteteve ndërsa mësonin nga njëri-tjetri për kulturat serbe dhe shqiptare. Vizitat përfshinë ndërveprime me organizatat e shoqërisë civile të fokusuar në rininë, institucionet kulturore dhe vendimmarrësit e rëndësishëm për çështjet rinore. Përveç kësaj, ne gjithashtu mirëpritëm të rinjtë nga Prishtina në një vizitë studimore në Beograd.

Plani Lokal i Veprimit për të Rinjtë në Vranjë

Që puna e të rinjve të jetë sistematikisht e rregulluar, është e nevojshme që të ekzistojë një dokument strategjik që do ta sigurojë atë. ALVED ka ndihmuar një grup të rinjsh entuziast të cilët dëshironin që Vranja të adoptonte planin e veprimit për të rinjtë përsëri pas 6 vitesh. Anëtarët e shoqatave "Aktivistët nga Lagjja", "Bota jonë, Rregullat tona" dhe Zyra për të rinj u mbledhën për të bërë, para së gjithash, një hulumtim mbi nevojat e të rinjve dhe më vonë për të adoptuar një dokument zyrtar, gjithmonë me mbështetjen profesionale të Ana Pecarskit. Me mbështetjen e përfaqësuesve kompetentë të autoriteteve lokale, Plani i Veprimit për të Rinjtë u miratua në fund të vitit 2021.

Plani Lokal i Veprimit për të Rinjtë në Vranjë:

<https://www.gradjanske.org/wp-content/uploads/2023/03/Strategjia-unapredjenja-polozaja-mladih-u-Vranju.pdf>

Puna me të rinjtë në jug të Serbisë rezultoi, midis të tjerave, në themelimin e një organizate rinore në Bujanoc "Qendra Rinore për Ndryshim", dhe një organizate rinore joformale në Leban. Vlen të theksohet edhe bashkëpunimi i shkëlqyer ndërmjet parlamenteve të nxënësve të shkollave "Sveti Sava" dhe "Sezai Surroi" në Bujanoc, bashkëpunim i cili u mbështet po ashtu edhe nga një grant i ALVED.



Ekipi i ALVED është krenar për bashkëpunimin e shkëlqyer mes parlamenteve të nxënësve të shkollave "Sezai Surroi" dhe "Sveti Sava" në Bujanoc, duke treguar bukurinë e jetës në një mjedis multietnik; foto: Beyond



NJË BOTË NË SHKOLLA (OWIS)

Metodologjia inovative mësimore "Një botë në shkollë" (OWIS) ka për qëllim përdorimin e filmave dokumentarë dhe metodave interaktive në mënyrë që të frymëzojë dhe edukojë gjeneratat e ardhshme të qytetarëve të angazhuar dhe aktivë. Zhvilluar nga organizata Njerëzit në Nevojë (PIN), OWIS mbulon një gamë çështjesh të rëndësishme dhe është projektuar për të inkurajuar mendimin kritik dhe për të promovuar



Secila orë e OWIS fillimisht filloi me shfaqjen e një dokumentari; foto: GI

një kuptim më të thellë të botës që na rrethon. Duke qenë prezent në 16 shkolla në komunën e Bujanocit, Lebanit, Preshevës dhe Vranjës, OWIS trajnoi 47 mësimdhënës dhe u zbatua me sukses në sistemin arsimor formal dhe atë joformal, duke përfshirë strukturat e tjera si qendrat kreative rinore, duke siguruar kështu një shtrirje të gjerë dhe qëndrueshmëri afatgjate. OWIS është integruar në shkolla si një mjet shtesë për të mbështetur kurrikulën e edukimit qytetar.

Programi përfshin 11 dokumentarë dhe materiale të tjera mësimore që ofrojnë bazën metodologjike për punën me materialet audio-vizuale dhe për të krijuar një hapësirë interaktive për të mësuar rreth një gamë çështjesh të rëndësishme. Këto çështje përfshijnë sjelljen në ambientin jetësor, hedhjen e ushqimit, migrimin, propagandën dhe dezinformimin, mediat sociale dhe reklamimin, sigurinë kibernetike, përfshirjen sociale në bazë të orientimit seksual, kohezionin social, dialogun midis brezave të ndryshëm, vullnetarizmin dhe diversitetin.

Me qasjen e vet angazhuese dhe interaktive, OWIS ka potencialin për të përmirësuar dhe pasuruar përvojën e të mësuarit tek nxënësit, duke ndihmuar në krijimin e një qytetarie më të informuar, kritike dhe aktive.



Siguria kibernetike si një nga temat e trajtuara në orët e mësimi; foto: GI

OWIS përtej klasës

Duke fuqizuar dhe frymëzuar të rinjtë për të ndërmarrë veprime dhe nxitur ndryshime pozitive në komunitetet e tyre, OWIS shkon përtej shfaqjes së një dokumentari.

Të frymëzuar nga filmat dokumentarë të OWIS, të rinjtë nga Bujanoci kanë organizuar një aktivitet për promovimin e përfshirjes sociale për migrantët.



Të frymëzuar nga dokumentarët OWIS, nxënësit e shkollës "Sezai Surroi" shkruanë ese dhe i ndanë ato me shokët e tyre; foto: GI

Ata kanë shkruar ese mbi temën e luftës në mes përpjekjeve, vështirësive dhe qëndrueshmërisë të migrantëve dhe i kanë shfaqur ato në korridorin e shkollës që edhe nxënësit tjerë të mund ti lexojnë. Përveç kësaj, ata **kanë vizituar Qendrën e Pranimit në Preshevë**, në mënyrë që të lidhen me bashkëmoshatarët e tyre dhe t'i përcjellin një mesazh mbështetjeje, duke nxitur përfshirjen e tyre aktive në shoqëri.



Dokumentari OWIS që trajton migrimin dhe integrimin i frymëzoi të rinjtë nga Bujanoci që të vizitojnë bashkëmoshatarët e tyre në Qendrën e Pranimit në Preshevë; foto: GI

Të rinjtë në Bujanoc shfaqën punë ekipore të jashtëzakonshme ndëretnike duke ndërmarrë një iniciativë frymëzuese për promovimin e masave mbrojtëse të kujdesit shëndetësor. Ata **në mënyrë efektive ngritën ndërgjegjësimin për kujdesin shëndetësor** përmes aktiviteteve si dizenjimi i posterave dhe vizatimeve të përbashkëta. Gjithashtu, ata organizuan leksione informative duke theksuar lidhjen midis shëndetit dhe mjedisit.



Mbrëmje e filmit në Preshevë, duke përbushur dëshirën e të rinjve për të eksploruar temat e dokumentarëve OWIS; foto: Livrit

Falë ndikimit të dokumentarëve OWIS, ne kemi krijuar një hapësirë të sigurt dhe tërheqëse për të rinjtë **për të diskutuar hapur për shëndetin mendor dhe promovuar mirëqenien përmes dialogut të hapur**. Shfaqja teatrale "Në shkëmb", e cila është



Përmes performancës teatrale të shfaqjes "Në shkëmb" nga shoqata "Budi", krijuam një platformë për diskutim mbi shëndetin mendor të të rinjve; foto: GI

shfaqur në Vranjë, Bujanoc dhe Leban, në mënyrë shumë të veçantë ka arritur të paraqesë sfidat e shëndetit mendor, duke i inkurajuar të rinjtë të shprehin lirshëm mendimet dhe emocionet e tyre.

● DEKLARATAT E MËSIMDHËNËSVE DHE NXËNËSVE:

► "Si mësimmhënëse, kam kuptuar se përdorimi i dokumentarëve është një mënyrë shumë efektive për të angazhuar nxënësit e mi dhe për të stimuluar interesin e tyre në temat përkatëse. Dokumentarët janë një mjet i fuqishëm që mund të ndihmojnë nxënësit të kuptojnë më mirë ide komplekse, krahasuar me vetëm leximin ose dëgjimin e shpjegimeve. Ata i japin jetë temave dhe i bëjnë ato më të paharrueshme".

► "Filmi 'Fëmijët në Internet' ngrit ndërgjegjësim lidhur me keqpërdorimin e fotografive në rrjetet sociale dhe thekson rëndësinë e empatisë, kuptimit dhe mbështetjes familjare për viktimat, gjë e cila është shumë e rëndësishme, veçanërisht tek ne ku viktimat shpesh stigmatizohen".

► Doracaku i OWIS:

[https://westernbalkans.peopleinneed.net/media/publications/1916/file/web_pin-toolkit-srb-global-](https://westernbalkans.peopleinneed.net/media/publications/1916/file/web_pin-toolkit-srb-global-education-with-films_alb_avg2022.pdf)

[education-with-films_alb_avg2022.pdf](https://westernbalkans.peopleinneed.net/media/publications/1916/file/web_pin-toolkit-srb-global-education-with-films_alb_avg2022.pdf)



OSHC TË FUQISHME = SHOQËRI AKTIVE

Fuqizimi i shoqërive civile formale dhe joformale në jug të Serbisë ishte një nga detyrat më të rëndësishme të projektit ALVED, sepse vetëm shoqëritë e fuqishme dhe të qëndrueshme mund të veprojnë aktivisht në afat të gjatë, edhe pas mbarimit të përkrahjes përmes projekteve të mëdha, siç është ky. Janë organizuar sesione trajnimesh në bazë të nevojave të anëtarëve të shoqërive lokale:



"Kurrë nuk është herët ta ndryshoni botën në të mirë" - Ky është slogani që na ka udhëhequr gjatë gjithë projektit; foto: Art Media Team, Vranjë

- ▶ Menaxhimi financiar dhe administrimi
- ▶ Si të përgatisim me sukses projektin tonë?
- ▶ Pjesëmarrja qytetare
- ▶ Ofrimi i shërbimeve për mbrojtje sociale

Panairi i Shoqërisë Civile

Në gusht të vitit 2022, në Bujanoc është mbajtur panairi i shoqërisë civile, në të cilin janë mbledhur organizatat nga jugu i Serbisë, kryesisht komunat të cilat janë pjesë e projektit ALVED. Panairi tregoi



Klubi i basketbollit "PLAY 017" në Bujanoc, sepse bota varet nga të rinjtë; foto: Art Media Team, Vranjë



Dominic Otway, Zëvendës Shef i Misionit në Ambasadën Britanike në Beograd, hap Panairin e Shoqërisë Civile në Bujanoc; foto: Art Media Team, Vranjë

nismat e ndërmarra nga qytetarët e Bujanocit, Lebanit dhe Vranjës, ku u krijua hapësira për shkëmbimin e ideve dhe shumë bashkëpunimeve të reja të mundshme. Gjithashtu, prania e përfaqësuesit të Ambasadës Britanike dhe të



Zërat Lokal: Panairi i Shoqërisë Civile i organizuar nga Njerëzit në Nevojë (PIN); foto: GI

gjithë partnerëve, pjesë të projektit ALVED, si dhe udhëheqësve të vetëqeverisjeve lokale, i tregoi organizatave lokale se nuk janë vetëm dhe se kanë mbështetjen e tyre në çdo gjë që do të ndërmarrin në të mirë të bashkëqytetarëve të tyre.



Kur bashkëpunimi i punës kthehet në miqësi - Radanska ruzha nga Lebani; foto: Art Media Team, Vranjë



SKEMA E GRANTEVE

PIN ka zbatuar tre skema të grantëve në mënyre që të sigurojë fonde për mbështetje të OSHC lokale në fushat e mëposhtme:

- ▶ Ndikimi i pandemisë Covid-19 në komunitete (2021)
- ▶ Zbatimi i planeve lokale të veprimit për përmirësimin e shërbimeve sociale (2022)
- ▶ Aktivizimi i të rinjve për të promovuar ndryshime pozitive në komunitetet e tyre (2022)



Fenniks: Prezantimi i puntorive të Qendrës së kujdesit ditor; foto: PIN



Forum teatër, shfaqje pa tekst nga shkollat "Sveti Sava" dhe "Sezai Surroi"; foto: Beyond



Shpallja e grantëve të para të ALVED - Ndikimi i pandemisë Covid-19 në komunitete; foto: PIN

Përfituesit e këtyre granteve janë zgjedhur në bazë të ideve dhe vizionit të tyre për mbështetjen e komuniteteve në të cilat ata jetojnë. Për disa prej përfituesve të granteve, kjo ishte hera e parë që ata merrnin financim nga një donator ndërkombëtar. Në total janë nënshkruar 19 kontrata për ndihmën e pakthyeshme për këto OSHC lokale dhe anëtarët e tyre të konsorciumit:

dhe aktivitetet e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit. Në këtë mënyrë, skemat e granteve kanë ngritur kapacitetet dhe aftësitë e shoqërive civile në komunat përkatëse në jug të Serbisë, duke përmirësuar aftësinë e tyre për të tërhequr donatorë të tjerë dhe për të vazhduar punën e tyre në çështje të rëndësishme në komunitetet e tyre.

● PËRFITUESIT E GRANTEVE TË ALVED:

- ▶ Shoqata Beyond
- ▶ Shoqata Beyond + parlamentet e nxënësve nga shkollat e mesme “Sveti Sava” dhe “Sezai Surroi”
- ▶ Shoqata e Grave Rome Bujanoc - 2 grante
- ▶ Shoqata e Grave Ruzha Leban + grupa joformale e nxënësve të shkollave të mesme
- ▶ Qendra për Zhvillim të Barabartë Rajonal CenTriR + Shoqata e Grave Ruzha, Leban
- ▶ Qendra për Aktivizëm Vranjë
- ▶ Komiteti për të Drejtat e Njeriut Vranjë (HRCVR) – 2 grante
- ▶ Forumi Rinor për Edukimin e Romëve (OFER)
- ▶ Shoqata The Future
- ▶ Shoqata Fenniks
- ▶ Shoqata Kulturore Rome Vranjska Banjë
- ▶ Shoqata për Ndihmë Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale (MNRO)
- ▶ Klubi Rinor i Basketbollit Play 017, Bujanoc
- ▶ Shoqata Bota jonë, Rregullat tona
- ▶ Organizata Humanitare Kulturore Alternativa Internazionale
- ▶ Shoqata qytetare Team 42 + grupa joformale e nxënësve të shkollës të mesme në Leban
- ▶ Unioni i Nxënësve të Shkollave të Mesme të Serbisë (UNSS) + Gjimnazi “Bora Stankoviç”, Vranjë



Organizata humanitare kulturore Alternativa Internazionale;
foto: Alternativa Internazionale

PIN ka ndarë rreth **250.000 GBP** për përfituesit e granteve. **Numri i drejtpërdrejtë i pjesëmarrësve në projektet ishte 4.052.**

PIN kanë ndërmarrë një qasje proaktive për të komunikuar hapur në mbështetje të këtyre OSHC lokale në përmirësimin e aftësive të tyre për të plotësuar kërkesat kontraktuale, duke përfshirë raportimin financiar dhe narrativ, prokurimin e mallrave dhe shërbimeve, si

Platforma “Vendi për ne”

Platforma “Vendi për ne” është një ndër krijimet e dobishme të projektit ALVED, e cila ka bërë të mundur pjesëmarrjen më të gjerë të komunitetit në proceset e vendimmarrjes. Kjo platformë ka treguar efikasitet në komunat e Vranjës, Bujanocit dhe Lebanit gjatë zbatimit të konsultimeve publike për planet e veprimit për përmirësimin e shërbimeve sociale. “Vendi për ne” inkurajon ndërveprimin midis anëtarëve të komunitetit, duke bërë më të lehtë

diskutimin e çështjeve të përbashkëta dhe gjetjen e zgjidhjeve që mund të përmirësojnë mjedisin e tyre. Përmes kësaj platforme, përdoruesit mund të angazhohen në aktivitete të ndryshme, duke përfshirë forumet dhe anketat, për të shprehur mendimet e tyre dhe për të marrë informacione rreth pikëpamjeve të komunitetit.

<https://zemljazanas.rs>





Çdo përfundim është një paralajmërim për një fillim të ri

Projektin ALVED ka lënë gjurmë të thella në komunitetet lokale ku u zbatua, si dhe te të gjithë anëtarët e Iniciativave Qytetare dhe Organizatës Njerëzitet në Nevojë (PIN) që ishin të përfshirë në këtë projekt.

Në Bujanoc, Vranjë, Leban dhe Preshevë, u hapën shumë çështje dhe u ndërmorën shumë iniciativa. Por më e rëndësishmja ishte fakti se shumë individë u bënë aktivistë me synimin për të përmirësuar cilësinë e jetës në komunitetin e tyre.

Me këtë rast, dëshirojmë të falënderojmë të gjithë ata që ishin pjesë e projektit ALVED dhe që ndihmuan në zbatimin e tij në çdo segment. Falënderojmë drejtuesit e vetëqeverisjeve lokale, qendrat për punë sociale, organizatat e shoqërisë civile, të rinjtë dhe të gjithë individët që kontribuan në arritjen e standardeve të larta të projektit. Këto standarde do të jenë një kriter për veprimtaritë e ardhshme në fushat e mbrojtjes sociale, edukimit joformal dhe aktivizmit rinor.

Një falënderim i veçantë shkon për qeverinë e Mbretërisë së Bashkuar si donator të këtij projekti, si dhe për organizatën Nisma për Ndryshim Paqësor (PCi), e cila drejtoi konsortiumin që zbatoi këtë projekt.



Iniciativat Qytetare është një organizatë qytetare për demokraci dhe edukim qytetar, e cila punon për më shumë se 25 vite në fuqizimin e shoqërisë civile, promovimin e aktivizmit dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në ndryshimet sociale. Iniciativat Qytetare aktivitetet i realizojnë nëpërmjet dy fushave tematike:

Fusha e parë i dedikohet aktivizmit qytetar. Përmes programeve për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, fushatave dhe rrjetëzimit, Iniciativat Qytetare punojnë në informimin dhe inkurajimin e qytetarëve për aktivizëm.

Fusha e dytë tematike i dedikohet kontributit për një shtet të hapur dhe përgjegjës, ku qytetarët pyeten në të gjitha nivelet.

Përmes punës së tyre, Iniciativat Qytetare synojnë të krijojnë një shoqërie të drejtë, ku qytetarët janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë dhe rolin e tyre, janë aktivë në shoqëri dhe të zëshëm në dialogun e vazhdueshëm me një shtet të hapur dhe të përgjegjshëm.

Gradanske inicijative
Kneza Miloša 4, 11000 Beograd
civin@gradjanske.org
gradjanske.org

Njerëzit në Nevojë (PIN) është një organizatë joqeveritare çeke që prej vitit 1992 ofron ndihmë në rajonet e trazuara dhe mbështet të drejtat e njeriut. Që atëherë, PIN ka arritur të shndërrohet në njërin nga organizatat joqeveritare më të mëdha në Europën Qendrore dhe Lindore. Sot, puna e PIN fokusohet në ndihmën humanitare dhe zhvillimin e rajoneve, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive demokratike, punën sociale në terren dhe edukimin, ngritjen e vetëdijes dhe informimit. PIN adreson probleme afatgjate në vendet në zhvillim si mungesa e ujit, pasiguria ushqimore, degradimi i mjedisit jetësorë dhe gasja e kufizuar në arsimin cilësor dhe shërbimet shëndetësore.

PIN Ballkani Perëndimor është pjesë e Departamentit për Ndihmë dhe Zhvillim të PIN (RDD), i cili ndihmon njerëzit në emergjencë, zonat e konfliktit, zonat e prekura nga katastrofat natyrore dhe ata që jetojnë në varfëri ekstreme. RDD vepron në 22 vende, duke implementuar çdo vit projekte në vlera të miliarda eurove për qindra mijëra njerëz në rajonet e rrezikuara.

People in Need Serbia
Višegradska 6/14, 11000 Belgrade
office.balkan@peopleinneed.net
westernbalkans.peopleinneed.net
PEOPLE IN NEED
Peopleinneed.net

